

VENDIM
Nr.1672, datë 24.12.2008

**PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS
SË KOMBINUAR TË MALLRAVE, 2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.9461, datë 21.12.2005 “Për nomenklaturën e mallrave dhe tarifën doganore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin dhe publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar të mallrave, 2009, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.1051, datë 16.7.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e publikimin zyrtar të nomenklaturës së kombinuar të mallrave”, si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha